



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

RAPORT
DEKLARIMI I DHURATAVE TË PRANUARA NGA
INSITUCIONET
2014

PRISHTINË, KORRIK 2015

Katalogu i dhuratave

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-050 si dhe Ligjin Nr. 04/L-228, Institucionet publike duhet t'i emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të dhuratave. Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën. Kopjet e katalogëve duhet t'i dërgojnë në AKK jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim.

Dorëzimi i katalogut të dhuratave

Agjencia kundër Korrupsionit, gjatë muajit mars të vitit 2015 ka pranuar njoftimin nga dhjetë (10) institucione të cilat kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, dhe njëzet e tetë (28) institucione tjera kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit 2014. Ndërsa nga institucionet tjera nuk kemi pranuar njoftime lidhur me pranimin ose jo të dhuratave.

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave gjatë këtij viti për vitin paraprak janë: Presidenca 38 dhurata protokollare 65 dhurata të rasti, Kuvendi i Kosovës 9 dhurata protokollare 1 dhurata të rasti, Zyra e Kryeministrit 24 dhurata protokollare 4 dhurata të rasti, Ministria e Integritimit Evropian 10 dhurata të rasti, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal 1 dhuratë të rasti, Këshilli Prokurorial i Kosovës 10 dhurata protokollare, Këshilli Gjyqësor i Kosovës 1 dhuratë protokollare 4 dhurata të rastit, Komuna e Mamushës 9 dhurata protokollare, Komuna e Parteshit 2 dhurata protokollare, dhe Zyra e Rregullatorit për Energji 14 dhurata të rastit.

Agjencia kundër Korrupsionit gjatë ditëve në vijim do të verifikoj regjistrimin dhe ruajtjen e dhuratave nëpër institucione dhe do të analizoj se si po respektohet ligji lidhur me pranimin e dhuratave.

Të dhënat e specifikuar lidhur me katalogët e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK, janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Institucioni	Protokollare	Rastit	Numri i dhuratave të deklaruar
Presidenca	38	65	103
Kuvendi i Kosovës	9	1	10
Zyra e Kryeministrit	24	4	28
Ministria e Integritimit Evropian	0	10	10
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	0	1	1
Këshilli Prokurorial i Kosovës	10	0	10
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1	4	5
Komuna e Mamushës	9	0	9
Komuna e Parteshit	2	0	2
Zyra e Rregullatorit për Energji	0	14	14
Totali	93	99	192

Tabela e ndarë nëpër institucione dhe llojin e pranimin të dhuratave.